

## Njoftim

Sot, më datë **27.03.2023**, ora **14:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1.Blerona Hasa (Relatore);**
- 2.Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3.Emona Muçi (Anëtare);**
- 4.Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5.Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar pranë sallës “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen që i përket:

**Paditës:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar në seancë nga z.Ledio Nuraj dhe z.Franci Nuri;

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ);

**Person i interesuar:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa.

**Objekti:** Ndryshimin e Vendimit nr.27, datë 16.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

1. Detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të çregjistrojë subjektin "Partia Demokratike", e regjistruar me nënkryetarin z.Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar;
2. Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, të përfaqësuar nga Kryetari z.Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023;
3. Rregullimin e pasojave duke detyruar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, të përfshijë subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari z.Sali Berisha, si pjesë e Koalicionit "Bashkë Fitojmë", koalicion i regjistruar nga KSHZ me vendimin e datës 18.03.2023.

me Vendimin Nr. 5, datë 27.03.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

**VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 27.03.2023.

**Tiranë, me 27.03.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**